



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 127, të vitit 2024, në ngarkim të të pandehurve **Jorgo Goro** dhe **Vasillaq Strakosha**, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Etleva Deda, me vendimin nr. **53**, datë **30.07.2025** vendosi:

I

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Jorgo Goro**, për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 2 (dy) vite burgim.
- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Jorgo Goro me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Jorgo Goro për 5 (pesë) vjet.
- Bazuar në nenin 33 të Kodit Penal, si dhe nenin 15 të ligjit nr. 81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, vuajtja e dënimit për të pandehurin Jorgo Goro do të kryhet në një nga institucionet për të dënuarit e rritur dhe të sigurisë së zakonshme.

II

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Vasillaq Strakosha**, për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Vasillaq Strakosha me 1 (një) vit burgim.

- Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurin Vasillaq Strakosha për një periudhë prej 2 (dy) vitesh, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.
- Urdhërohet i pandehuri Vasillaq Strakosha të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës pranë vendbanimit të tij.
- Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Vasillaq Strakosha për 5 (pesë) vjet.
- **Në lidhje me provat materiale**, konform nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, praktikat e sekuestruara enteve përkatëse, të mbeten pjesë e fashikullit të gjykimit, për efekt të procedimit penal të ndarë ndaj të pandehurit Jerasimo Bashi.
- Shpenzimet proceduriale të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak, në masën 63.653 (gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë, gjatë seancës paraprake dhe gjatë gjykimit (sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi), i ngarkohen të pandehurve solidarisht.
- Urdhërohet Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të ekzekutojë këtë vendim.
- Kundër vendimit lejohet apel brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 30.07.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar